

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kombëtarja nis përgatitjet për UEFA Nations League, trajneri Maran shpall të shtunën listën e të grumbuluarve
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sport/kombetarja-nis-pergatitjet-per-uefa-nations-league-trajneri-maran-shpall-t-i586821
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 08:15:25 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 08:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	40c9aee05585300c75e9c460f1b79038c5154be4415e68266aff58d774ab2545
TEKSTI	9a07ac7bfb9cb6b10cda7207282a4b62d03c242692a2c4c008ab664a010b9c5b
PAMJA	725a34539e72510de7163d64045ae3202c0dcfd27887d31d687ffc3a7bf30a6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8928e9c682c6f9fb55743698c94fc0755fb70697b4deaf6d29d842aae6ba8731
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8928e9c682c6f9fb55743698c94fc0755fb70697b4deaf6d29d842aae6ba8731>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

ie Ali Ahmeti: Jam i indinjuar me Albin Kurtin, t'i lere pas zenkat me mua e Ramen Edmond Spaho: PD e ka mbeshtetur krijimin e Gjykes Speciale, Berisha votoi pro ngrit fundit

Kombëtarja nis përgatitjet për UEFA Nations League, trajneri Maran shpall të shtunën listën e të grumbulluarve



18 Shtator 2026, 10:50 Sport TEMA



Kombëtarja shqiptare do të nisë këtë fundjavë përgatitjet për ndeshjet e UEFA Nations League, me kuqezinjtë që do të kenë një kalendar të ngjeshur gjatë muajve shtator dhe tetor, me katër sfida në program.

Trajneri i Kombëtares, Rolando Maran, do të shpallë **të shtunën, më 19 shtator, në orën 11:00 në Shtëpinë e Futbollit**, listën e lojtarëve të grumbulluar për këto përballje.

Shpalljen e listës, tekniku italian do ta bëjë gjatë **konferencës për media**, ku do t'u përgjigjet pyetjeve të gazetarëve dhe do të komentojë zgjedhjet e tij për sfidat e radhës.

Kuqezinjtë do të përballen fillimisht me **Bjellorusinë në shtëpi, më 26 shtator**, ndërsa tre ditë më pas do të udhëtojnë drejt San Marinos për ndeshjen e 29 shtatorit.

Më pas, Kombëtarja do të luajë në transfertë ndaj **Finlandës më 3 tetor**, përpara se të rikthehet në shtëpi për sfidën e dytë ndaj **San Marinos, më 6 tetor**.

Ndërkohë, grumbullimi i skuadrës do të nisë **të hënën**, kur lojtarët e ftuar do të bashkohen me ekipin dhe do të zhvillojnë pasditen e po asaj dite seancën e parë stërvitore në **Shtëpinë e Futbollit**.

Katër ndeshjet e shtatorit dhe tetorit do të jenë një tjetër etapë e rëndësishme për Kombëtaren shqiptare, që synon të vijojë rrugëtimin në UEFA Nations League me përgatitje maksimale dhe përkushtim në çdo sfidë.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Ndahet nga jeta Esat Bushati, legjenda e Vllaznisë/ Beci: Futbolli shkodran humbi sot një nga emrat e tij të respektuar](#)

16:55 Sport / 2 komente

Brazil, presidenti Lula i bën apel Ancelottit: Merr më shumë futbollistë që luajnë në kampionatin tonë

13:00 Sport

Presidenti i Federatës Gjermane “i shpall luftë” Infantinos: Është e rëndësishme që sistemi i tij të marrë fund

22:20 Sport / 4 komente

UEFA Youth League - Partizani shkëlqen në ndeshjen e parë, fiton pastër në transfertë ndaj Valletta-s

22:05 Sport / 2 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.